N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01-1461 Dt. 02-05-2024
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 01/3
Nr. Prot. / Br. Prot / Prof.No: 4324
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 33
Data / Datum / Date: 07.05.24
PRISHTINË/A NO.1

# Raporti tre mujor, Janar-Mars 2024 TM1

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e katër (4) të rregullt të mbajtur me datë 30.04.2024 pas shqyrtimit të Raportit TM1-2024 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i BD: |
| Nënshkrimi | **Faruk MUJKA** | **Bajram MUSTAFA** |
| Data: 30.04.2024 | | |

Ndërmarrja Hidroekonomike "IBËR-LEPENC" sh.a. Prishtinë-Priština Vodoprivredno preduzeće d.d.

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 - Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

| | |
|---|---|
| *Për* : | **Bordin e Drejtorëve** |
| *Nga*: | **Faruk Mujka - Kryeshef Ekzekutiv – NH "Iber-Lepenc" Sh.A** |
| *Lënda:* | **Raport tremujor i punës: Janar-Shkurt-Mars 2024** |
| *Data:* | **24.04.2024** |

***Efikasiteti i përgjithshëm tremujor Janar-Shkurt-Mars 2024***

**Aktivitetet e Njësive Afariste dhe Departamenteve**

***Njësia afariste „Uji dhe Gjenerimi"***

Në Nj.A."Uji dhe Gjenerimi" gjatë tremujorit(TM1) Janar-Mars 2024 është punuar në mirëmbajtjen e kanalit kryesor për sigurimin e rrjedhjes se ujit dhe furnizimin e konsumatorëve të IL. Pas shqetësimeve te banoreve përgjatë kanalit sekondar Besi-Sp-Çagllavicë ,gjegjësisht banoret e lagjës Qendresa, është ber pastrimi komplet i segmenteve nga dalja e sifonit të Prishtevkës deri ne SP Çagllavica. Me qëllimin e përgatitjes se sezonës se ujitjes kemi filluar në pastrimin e kanaleve sekondare. Për shkak të defekteve në stabilimentet elektro-mekanike në HC, gjatë kësaj periudhe kohore në shumicën e kohës është punuar me njërin gjenerator.

Sipas kërkesave te shfrytëzuesve të ujit nga sistemi i IL-it gjatë tremujorit janar-mars janë distribuuar këto sasi **13,092,081 m$^3$**

| TMI | $m^3$ |
|---|---|
| **KRU Mitrovice** | **4,997,413** |
| **KRU Mitrovice ( Vushtrri)** | **1,840,011** |
| **KUR Prishtina(Shkabaj)** | **3,784,800** |
| **KUR Prishtina(Drenas)** | **812,367** |
| **NewCo Ferronikel CoL.L.C** | **678,816** |
| **KOSOVA B** | **2,751,840** |
| **TOTALI** | **14,865,245** |




Paraqitja grafike e sasive te distribuara të ujit në $m^3$ Janar-Mars 2024

| | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|
| **KRU Mitrovice** | **5,443,200** | **5,310,357** | **4,751,622** | **4,997,413** |
| **KRU Mitrovice ( Vushtrri)** | **1,476,046** | **1,649,265** | **1,696,841** | **1,840,011** |
| **KUR Prishtina(Shkabaj)** | **3,467,044** | **4,261,384** | **2,935,360** | **3,784,800** |
| **KUR Prishtina(Drenas)** | **722,350** | **928,890** | **726,899** | **812,367** |
| **NewCo Ferronikel CoL.L.C** | **550,313** | **243,566** | **259,760** | **678,816** |
| **KOSOVA B** | **2,721,600** | **2,543,400** | **2,721,600** | **2,751,840** |




Gjatë kësaj periudhe të tremujorit Janar-Mars nga HC Ujëmani janë gjeneruar **18,362.82 MWh** gjegjësisht **31,500.00 MWh** ( injektuar në sistemin transmetues), apo **42% (31,500.00 Mwh)** më pak se të parapara me planin e biznesit si pasoj e defekteve në HC.

*Krahasimi i gjenerimit me periudhën e njejtë për vitet 2016-2024*




Niveli i ujit në akumulim me 1 janar ka qenë në kotën 685.28 m (301 mil. $m^3$ ,shkalla 53.50) ndërsa me 31 mars nivel ka qene në kotën 686.37 m (306 mil. $m^3$ ,shkalla 50.50)






*Ne tabelën e mësipërme është paraqitur në mënyrë grafike nivelet e akumulimit ne çdo fillim muaj*

Prurjet mesatare në akumulimin Ujëman gjatë tremujorit TM1 ishin **11.3** $m^3/sec$

| | **Vëllimi $10^6m^3$** | **Prurjet $m^3/sec$** |
|---|---:|---:|
| Janar | **301** | **12.20** |
| Shkurt | **304** | **9.40** |
| Mars | **298** | **12.50** |




| | | | **Prurjet gjate viteve $m^3/sec$** | | | | | | |
|---|---:|---:|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2024** | **2023** | **2022** | **2021** | **2020** | **2019** | **2018** | **2017** | **2016** |
| ***Janar*** | ***12.2*** | ***32.1*** | ***8.4*** | **23.88** | **5.3** | **5.6** | **8** | **4.5** | **7.1** |
| ***Shkurt*** | ***9.4*** | ***18.5*** | ***12.7*** | **39.19** | **10.9** | **20.03** | **21.1** | **18.2** | **16.9** |
| ***Mars*** | ***12.5*** | ***23.1*** | ***13.3*** | **20.92** | **21.8** | **22.14** | **36.3** | **25.2** | **31.8** |

## Prurjet gjatë viteve për TM1 gjatë viteve 2016-2024



***Raporti i punës në Nj.A. "Ujitja" për Janar-Shkurt-Mars (TM1) 2024.***

Departamenti"Ujitja" gjatë periudhës Janar-Mars (TM1) 2024, së bashku më tri Njësitë Punuese:Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran, ka vazhduar me aktivitetet e punës që dalin konform detyrave të punës gjate tre mujorit te parë të vitit.

Puna e Departamentit "Ujitja" gjatë TM1 ka përfshirë këto veprime si në vijim: kontrollimin e infrastrukturës së ujitjes, mirëmbajtjen e Stacioneve Pompike, përfshirë këtu, mirëmbajtjen makinerike dhe elektrik, përgatitjen e sistemit të ujitjes për fillimin e sezonit të ri të ujitjes, regjistrimin e aseteve të ndërmarrjes, etj.

**Kontrolli i infrastrukturës së ujitjes**

Punëtorët në terren kanë vazhduar me vezhgimin rutinor të infrastrukturës së ujitjes, për të siguruar që sistemi të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet e ndryshme keqbërisëse. Këto kontrolle kanë përfshirë inspektimin e pjesëve fazonerike, Pusetat, Hidrantat sidhe përcjelljen nese afër apo mbi gypa të ujitjes po ndertohen ndertime të ndryshme.

**Mirëmbajtja e stacioneve pompike**

Punonjësit e Departamentit "Ujitja" në tri Njësitë Punuese, kanë vazhduar me mirëmbajtjen e rregullt të pjesës se makinerike dhe elektrike nëpër të gjitha Stacionet Pompike. Kontrolli rutinor i prezencës së punëtorëve nëpër Stacione Pompike është bërë për të siguruar që punonjësit janë në vendin e tyre të punës dhe se po kryejnë detyrat e tyre me efikasitet dhe saktësi.

**Regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes**

Në muajin Janar 2024, më vendim të Kryeshefit në të tri Njësitë Punuese janë formuar komisionet për regjistrimin e aseteve të ndërmarrjes.

Këto komisione, në koordinim më Zyrën e Financave, gjatë muajit Janar 2024, kanë përfunduar regjistrimin e aseteve në të tri Njësitë Punuese. Ky është një proces i rëndësishëm për të siguruar që të gjitha asetet janë të dokumentuara dhe në rregull.

**Shkurt**- në fshatin Akrashticë, Komuna Vushtrri, rrjedha e ujit (përroji) prap ka zbuluar tubacionin V-2, ky tubacion vitin e kaluar është dëmtuar nga vershimet e mdha që kanë ndodhur gjatë muajt Jnar 2023.

Prandaj punëtorët e Nj.P. në Vushtrri janë angazhuar në mbrojtjen e tubacionit V-2 duke bartur pjesë të betonit dhe materiale të tjera dhe duke e mbrojtur tubacionin V-2.

Në Njësitë Punuese në Shkabaj dhe Komoran, udhëheqësit e njësive Punuese së bashku më teknikët dhe punëtorët e terenit kanë vizituar të gjithë sistemin e ujitjes dhe kanë bërë pershkrimin të gjendjës teknike të sistemit të ujitjës.

Një pjesë e punëtorëve që i kanë përfunduar pushimet më herët, gjatë muajit shkurt, i kanë vizituar fermerët që kanë borxhe të vjetra me qellim të inkasimit te mjeteve nga ujitja për vitet e kaluara, si dhe mbledhja e lateralëve nga fermerët të cilët nuk kanë kontraktuar në vitin 2023. Pagesa janë duke u bërë nga fermerët, gjithashtu në vazhdimësi jemi duke i informuar ata, se në rast se nuk inkasohet borxhet e vitit të kaluar, ata do dërgohen në procedura përmbarimore.

**Mars** – gjatë këti muaji në të tri Njësitë Punuese ka filluar zbatimi i planit të veprimit për përgatitjen e sistemit të ujitjes për fillimin e sezonit të ri të ujitjes. Ky plan është i bazuar edhe në kërkesat e fermerëve,

pra në pjesë të hidrosistemit ku fermerët shprehin interesim për ujitjen e tokave bujqësore, ne, do të veprojmë me prioritet.Në të tri Njësit Punuese punët kanë filluar në pastrimin e kanaleve të hapura, dhe është bërë prerja e shkurreve përgjatë dy anëve të kanalit, pastrimi i pusetave, si dhe përpunimi dhe vajosja e fazonerisë.

Gjatë muajit Mars kemi zhvilluar shumë takime me fermerët, më të cilët është diskutuar rreth nevojave të tyre për ujitje, si dhe i kemi informuar fermeret për mundësitë tona të furnizimit me uji për ujitje dhe përgatitjen e sistemit të ujitjes për sezonin e ri të ujitjes 2024.

Poashtu jemi takuar edhe me Drejtorët e Drejtorive Komunale për Bujqësi, të komunave: Vushtrri, Obiliq, Drenas, Prishtinë dhe Mitrovicë, e të cilëve edhe më E-mail u kemi kërkuar strukturen e te mbjellurave për vitin 2023.

Poashtu me Drejtoret Komunal për Bujqësi kemi diskutuar edhe për Memorandumin e Bashkëpunimit, më të cilin komunat do i subvencionojnë fermerët për çmimin e ujitjës.

Bazuar në diskutimet me Drejtorët, besojmë që Memorandumet do të nënshkruhen me të gjitha komunat më përjashtim të komunës së Drenasit, të cilët me arsyetimin se nuk kanë buxhet nuk do e nenshkruajn Memorandumin.





*Pastrimi kanalit te hapur, nga lagja e Nishorve deri në Stacionin Pompik Fushtice*





*Pastrimi i Bazenit Kompenzues në Gjyrashin;     Kositja e barit në Njësin Punuese Komoran*

*Shërbimi i Financave*

## 1. Të hyrat

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 të hyrat e Ndërmarrjes janë realizuar në vlerë 2,341,134.26€, ndërsa ishin planifikuar të realizohen në vlerë prej 2,117,336.67€. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave është në nivelin 111%.

- Nga energjia elektrike janë realizuar të hyrat në vlerë prej 1,774,114.37 €, ndërsa kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyrat në vlerë 1,575,000.00€ apo shprehur në përqindje realizimi ishte në nivelin 113%.
- Nga shitja e ujit të papërpunuar janë realizuar të hyrat në vlerë prej 567,013.23€, ndërsa të planifikuara ishin 542,336.67€, pra 105%.
- Të hyrat tjera në vlerë 6.66€ janë të hyra nga Lënda përmbarimore.

Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të hyrat sipas llojit, sasisë dhe vlerës monetare:

**Tabela nr. 1**

**RAPORTI I BIZNESIT PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2024**

| Nr. | Emërtimi | Njësia matëse | Realizimi TM1 2023 | Plani TM1 2024 | Realizimi TM1 2024 | % e realizimit në raport me planin | % e realizimit në raport me 2023 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 (5:4) | 7 (5:3) |
| **1** | **PRODHIMI** | | | | | | |
| 1 | Energjia elektrike | Mwh | 46,504.71 | 31,500.00 | 18,301.84 | 58 | 39 |
| 1 | Uji | m³ | 13,092,082.00 | 14,711,317.00 | 14,865,067.00 | 101 | 114 |
| 1 | Ujitja | ha | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **2** | **TË HYRAT** | | **4,047,727.63** | **2,117,336.67** | **2,341,134.26** | **111** | **58** |
| 2 | Energjia elektrike | € | 3,556,294.00 | 1,575,000.00 | 1,774,114.37 | 113 | 50 |
| 2 | Uji | € | 487,174.00 | 542,336.67 | 567,013.23 | 105 | 116 |
| 2 | Ujitja | € | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| 2 | Të tjera | € | 4,259.63 | 0.00 | 6.66 | 0 | 0 |

## 1. Shpenzimet

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 shpenzimet e Ndërmarrjes kanë arritur vlerën prej 1,258,149 €, ndërsa ishin planifikuar të shpenzohen 1,234,340€, pra realizimi i shpenzimeve është në nivelin 102%. Shpenzimet kryesore të Ndërmarrjes gjatë këtij 3 mujori janë në paga dhe meditje ku vlera e tyre arrin në 1,036,732 €, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve janë kryesisht taksat e ndryshme për rregullatorë, shpenzimet komunale, shpenzimet e karburanteve dhe shpenzimet e mirëmbajtjes.

## 1. Rezultati financiar

Gjatë këtij tremujori Ndërmarrja ka pasur rezultat negativ financiar në vlerë prej -74,094€. Në vijim mund të shihet pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve ku vërehet se shpenzimet totale janë më të larta se sa të hyrat 3 mujore:

| Kodi | Kategoria e shpenzimeve | Realizimi TM1 2023 | Plani 2024 | Realizimi TM1 2024 | Indeksi % | Indeksi % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4=(2:1) | 5=(2:3) |
| **B.1** | **Pagat dhe meditjet** | **809,201.00** | **860,939.10** | **1,036,732.14** | **120** | **128** |
| B.1.1 | Pagat neto të punëtorëve | 681,641.00 | 696,720.00 | 509,085.60 | 73 | 75 |
| B.1.2 | Pagat jasht orarit | 13,142.00 | 17,800.00 | 13,467.89 | 76 | 102 |
| B.1.4 | Pagat tjera 24 paga-Bonuset | 0.00 | 0.00 | 272,436.07 | 0 | 0 |
| B.1.5 | Paga përcjellëse | 4,551.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.1.6 | Shujta | 45,651.00 | 70,262.00 | 53,812.00 | 77 | 118 |
| B.1.7 | Tatimi në Pagë | 0.00 | 0.00 | 66,970.39 | 0 | 0 |
| B.1.8 | Kontributi i ndërmarrjes 5% | 38,476.00 | 40,997.10 | 49,262.25 | 120 | 128 |
| B.1.9 | Kontributi i puntorit 5% | 0.00 | 0.00 | 49,262.25 | 0 | 0 |
| B.1.10 | Antarsia Sindikale | 0.00 | 0.00 | 1,932.89 | 0 | 0 |
| B.1.11 | Shërbimi shëndetësor | 17,032.00 | 23,910.00 | 14,676.90 | 61 | 86 |
| B.1.12 | Pagat e Bordit | 8,708.00 | 11,250.00 | 5,825.90 | 52 | 67 |
| **B.2** | **Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare dhe reprezentacionet** | **1,625.42** | **6,490.00** | **9,123.50** | **141** | **561** |
| B.2.1 | Shpenzimet e udhëtimëve zyrtare | 959.02 | 2,200.00 | 4,624.32 | 210 | 482 |
| B.2.2 | Shpenzimet e reprezentacionit | 666.40 | 4,290.00 | 4,499.18 | 105 | 675 |
| **B.3** | **Shpenzimet e marketingut** | **0.00** | **0.00** | **0.00** | **0** | **0** |
| B.3.2 | Shpenzimet e marketingut | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.4** | **Shpenimet e mirëmbajtjës** | **11,629.65** | **18,531.00** | **7,195.28** | **39** | **62** |
| B.4.1 | Mirembajtja dhe servisimi i automjeteve | 5,879.00 | 7,401.00 | 1,249.84 | 17 | 21 |
| B.4.2 | Mirëmb.e objekteve dhe paisjeve | 121.00 | 3,000.00 | 192.37 | 6 | 159 |
| B.4.3 | Mirëmbatja infrastrukturore | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.4.4 | Mirëmbajtja tekniko-informative | 5,272.00 | 6,930.00 | 5,396.97 | 78 | 102 |
| B.4.5 | Servisimi dhe mbushja e aparatave kundër zjarrit | 357.00 | 1,200.00 | 356.10 | 30 | 100 |
| **B.5** | **Shpenzimet komunale** | **61,453.69** | **67,853.87** | **50,027.67** | **74** | **81** |
| B.5.1 | Shpenzimet e ujit | 682.00 | 1,440.00 | 478.62 | 33 | 70 |
| B.5.2 | Shpenzimet për mbeturina | 541.00 | 510.00 | 496.32 | 97 | 92 |
| B.5.3 | Energjia Elektrike | 56,738.00 | 62,411.87 | 46,433.58 | 74 | 82 |
| B.5.4 | Shpenzimet e ngrohjes (Termokos) | 3,492.00 | 3,492.00 | 2,619.15 | 75 | 75 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **B.6** | **Material harxhues** | **5,680.78** | **18,011.18** | **1,169.23** | **6** | **21** |
| B.6.1 | Artikuj me vlerë të vogël | 5,642.00 | 7,516.18 | 311.62 | 4 | 6 |
| B.6.2 | MHT-mbrojtja higjeno-teknike | - | 6,748.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.6.3 | Material elektrik | 24.00 | 0.00 | 15.68 | 0 | 65 |
| B.6.4 | Material higjenik | 14.00 | 1,449.00 | 14.32 | 1 | 102 |
| B.6.5 | Material për zyre | | 2,298.00 | 827.61 | 36 | 0 |
| **B.7** | **Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes** | **2.00** | **4,000.00** | **0.00** | **0** | **0** |
| B.7.1 | Material për ndërrimin dhe riparimin e gypave në rrjetin e ujitjes | 2.00 | 4,000.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.8** | **Shpenzimet për shërbime** | **10,497.48** | **13,400.00** | **2,811.00** | **21** | **27** |
| B.8.1 | Trajnime | 10,357.00 | 13,300.00 | 2,713.00 | 20 | 26 |
| B.8.2 | Shpenzime te shtypjes | 140.00 | 100.00 | 98.00 | 98 | 70 |
| B.8.3 | Shpenzime projektuese | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.9** | **Shpenzime tjera** | **7,168.30** | **13,762.50** | **7,141.65** | **52** | **100** |
| B.9.1 | Shpenzime tjera | 5,627.00 | 12,000.00 | 5,208.79 | 43 | 93 |
| B.9.2 | Parkingu për automjete | 1,239.00 | 1,462.50 | 1,075.86 | 74 | 87 |
| B.9.3 | Autolarja | 172.00 | 300.00 | 332.00 | 111 | 193 |
| B.9.4 | Çregjistrimet | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.9.5 | Konkurset | 130.00 | 0.00 | 525.00 | 0 | 0 |
| **B.12** | **Shpenzimet e telekomunikimit** | **2,417.34** | **7,194.00** | **5,178.73** | **72** | **214** |
| B.12.1 | Telefonia fikse | 294.00 | 345.00 | 116.01 | 34 | 39 |
| B.12.2 | Telefonia mobile | 1,844.00 | 2,535.00 | 1,392.26 | 55 | 76 |
| B.12.3 | Kablloviku | 54.00 | 33.00 | 179.34 | 543 | 332 |
| B.12.4 | Interneti | 193.00 | 4,281.00 | 3,453.42 | 81 | 1789 |
| B.12.5 | Shpenzimet postare | 32.00 | 0.00 | 37.70 | 0 | 118 |
| **B.13** | **Derivatet** | **5,692.70** | **9,916.00** | **5,506.72** | **56** | **97** |
| B.13.1 | Nafta | 5,317.00 | 8,960.00 | 5,301.74 | 59 | 100 |
| B.13.2 | Benzina | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.13.3 | Vajrat | 375.00 | 956.00 | 204.98 | 21 | 55 |
| **B.14** | **Detyrime kontigjente** | **0.00** | **60,000.00** | **0.00** | **0** | **0** |
| B.14.1 | Detyrime kontigjente | 0.00 | 60,000.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.15** | **Provizionet dhe taksat** | **165,855.90** | **142,494.28** | **133,263.37** | **94** | **80** |
| B.15.1 | Tatimi ne pronë | 712.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.15.2 | Taksa për rregullatorë | 129,937.00 | 69,013.65 | 54,999.83 | 80 | 42 |
| B.15.2.1 | Taksa për MMPH | 0.00 | 68,797.63 | 74,082.67 | 108 | 0 |
| B.15.3 | Provizioni bankar | 472.00 | 300.00 | 1,041.68 | 347 | 221 |
| B.15.4 | Sigurimi i automjeteve | 2,387.00 | 2,988.00 | 2,270.56 | 76 | 95 |
| B.15.5 | Regjistrimi i automjeteve | 873.00 | 1,395.00 | 868.63 | 62 | 99 |
| B.15.6 | Interesi i kredisë BB | 31,474.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| B.15.7 | Tatimi në fitim | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.16** | **Kompenzimi i dëmëve** | **0.00** | **2,499.00** | **0.00** | **0** | **0** |
| B.16.1 | Kompenzimi i dëmëve | 0.00 | 2,499.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| **B.17** | **Shpenzimet nga imbalanca** | **0.00** | **9,249.00** | **0.00** | **0** | **0** |
| B.17.1 | Shpenzimet nga imbalanca | 0.00 | 9,249.00 | 0.00 | 0 | 0 |
| | **Total** | **1,081,224.26** | **1,234,339.93** | **1,258,149.29** | **102** | **116** |

## 1. Rrjedha e parasë - Likuiditeti

Në vijim është paraqitur gjendja e bankave dhe parasë së gatshme me 31.03.2024

| Gjendja e bankave me daten 31.03.2024 | | |
|---|---|---|
| | | |
| | BpB | 275,418.58 |
| Afatizimi | NLB | 2,000,000.00 |
| | BKT Ë.B | 270,378.60 |
| | ARKA Ë.B | 387.69 |
| | ARKA | 1,400.65 |
| Kapitali | BE | 25,000.00 |
| | TEB | 360,917.19 |
| | NLB | 921,916.03 |
| | BKT | 3,257,854.33 |
| | BE | 905,693.84 |
| Afatizimi | BKT | 1,000,000.00 |
| | Credins | 988.00 |
| Afatizimi | Credins | 1,000,000.00 |
| Kolateral | PCB | 5,000.00 |
| | PCB | 995,055.00 |
| | **Gjithesej:** | **11,020,009.91** |

## 2. Detyrime kontigjente me shpjegime

| | | |
|---|---|---|
| B.14.1 | Detyrime kontigjente | 240,000.00 |
| 1 | Adelina Rama | 100,000.00 |
| 2 | Te tjera te raportuar ne raportin vjetor sipas zyres ligjore | 140,000.00 |
| 3 | Kompenzimi i dëmeve për tokën dëme tjera | 10,000.00 |

## ***Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta***

Ky tremujorës i vitit 2024 e ka gjetur Departamentin e Shërbimeve të Përbashkëta me realizimin e disa projekteve shumë të rëndësishme për ndërmarrjen, ku dy prej tyre më të rëndësishmet dhe të cilat kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe performancës së brendshme duke arritur një sukses në realizimin e objektivit kryesor, atë të digjitalizimit të Administratës si dhe rritjes së sigurisë së rrjetit brenda drejtorisë si dhe të gjitha njësive punuese të ndërmarrjes. Ju informojmë që pas shumë sfidave disa vjeçare kemi arritur të implementojmë projektin e instalimit të Firewallëve(Pajisje mbrojtese te rrjetit) dhe Ruterëve modern në Drejtori dhe nëpër Njësitë Punuese Shkabaj, Komoran dhe Vushtrri si dhe krijimin e një rrjeti të brendshëm të sigurt duke eliminuar shumë probleme që na kanë përcjellur deri më tani dhe njëkohësisht duke rritur sigurinë dhe mbrojtjen e informatave dhe rrjetit në përgjithësi. Vlenë të theksohet se me instalimin e këtyre Pajisjeve moderne kemi eliminuar humbjen prej më shumë se 30% te rrjetit tonë i cili ka ardhur si shkak i mos pasjes se kontrollit të rrjetit me këtë rast kemi kufizuar hapësirën e përdorimit të aplikacioneve jozyrtare si dhe programeve të paautorizuara të cilat nuk kanë të bëjnë me punët e përditshme të stafit tone.

Projekti tjetër i rëndësisë shumë të madhe është implementimi dhe instalimi i pajisjeve për evidentimin e Hyrjeve/daljeve në drejtori, njësi punuese si dhe në të gjitha objektet ndarëse dhe stacionet pompike të ndërmarrjes duke përfshi edhe HC Ujmanin. Duke pasur parasysh se kjo ishte kërkesë me prioritet nga Kryeshefi Ekzekutiv që nga marrja e mandatit të tij, si kërkesë për ta rritur llogaridhënjen dhe diciplinen në punë dhe vijueshmërinë e saj, tash e tutje me pajisjet e reja si dhe softuerin e instaluar në ato pajisje Kryeshefi, Menaxhmenti dhe drejtoritë përkatëse do të jenë në gjendje që në kohë reale të shohin dhe menaxhojnë lëvizjet e stafit të tyre si dhe kontrollin më të detajuar të vonesave apo daljeve pa leje.

Në javët në vazhdim presim implementimin edhe të paketës Office .365 nga Microsoft, paketë e cila do të rregullon njëherë e përgjithmonë komunikimet e email-evë në përgjithësi si dhe do të ofrohet ruajtja e tyre dhe mirëmbajtja në cloud pra në serveret e Microsoft-it. Me këto projekte në përfundojme fazën e parë dhe kryesore të implementimit të projektit të digjitalizimit të Administratës në përgjithësi si prioritet dhe objektiv shume i rëndësishëm dhe vazhdojmë deri në plotësimin dhe realizimin e objektivave të Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit te Drejtorëve. Poashtu, vlen të përmendet edhe projekti shumë i rëndësishëm i përfunduar me sukses, ai i renovimit të toaletëve si dhe realizimi i dy zyreve shtesë në drejtorinë e ndërmarrjes, projekte këto të nevojshme për tu realizuar shumë vite më përpara në të mirë të përmirësimit dhe ofrimit të kushteve sa më të mira higjienike dhe të punës për punëtorët tonë.

## ***Zyra e Burimeve Njerëzore:***

Janë zhvilluar procedurat adekuate për pranim në marrëdhënie pune për konkurset e brendshme për Drejtor Departamenti për Shërbime të Përbashkëta, Drejtor Departamenti për “Uji dhe Gjenerimi”, Drejtor Departamenti për “Planifikim dhe Zhvillim” si dhe Drejtor Departamenti “Ujitja”... për tri pozitat e para, janë mbajtur të gjitha veprimet sipas Udhëzimit Administrativ 2017/07, ku pas nënshtrimit të testeve me shkrim nga kandidatët si dhe intervistave, janë përzgjedhur kandidatët me më shumë pikë dhe të njejtit kanë nënshkruar kontratat për themelimin e mardhënies së punës sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Shpallje konkursi për pozitën Drejtor i Departamentit Ujitja, pasi që në këtë pozitë kemi pasur vetëm një kandidat.

- Zbatimi i Rregulloreve për Sistematizim dhe Organizimin e brendshëm të Ndërmarrjes, harmonizimi e sistematizimit brenda Ndërmarrjes, shpallja e konkurseve të brendshme dhe të jashtme, sipas Ligjit të Punës dhe U.A 2017/7 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

- Kanë përfunduar të gjitha procedurat për rekrutim me konkurs të brendshëm për pozitat: Shef Njësie Shkabaj, Shef Njësie Komoran si dhe pozitat tek Departamenti “Uji dhe Gjenerimi” ku përfshihen pozitat: Shef i NJP Ujman, Shef i Shërbimit elektromakinerik, Shef i Shërbimit hidro – ndërtimtari dhe Shef i Shërbimit SCADA.

- Bazuar në Udhëzimin Administrativ 2017/07 për Procedurat e Rekrutimit, procesi ka përfundu në mënyrë të rregullt, ku pas rekrutimit të njejtëve iu është lëshuar kontrata e nënshkruar nga punëdhënësi.

- Poashtu kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për pozitën: Shef për Libermbajtje, Tatim dhe Raportim me konkurs të jashtëm, ku është përzgjedhur kandidati sipas procedurave ligjore me më shumë poena dhe I njejti ka filluar punën menjëherë pas përfundimit të procedurave.

- Fillimi i procedurave për 8 konkurse të jashtme, pasi që të për njejtat nuk kishte kandidatë për konkurs të brendshëm.

- Bazuar në Udhëzimin Administrativ 2017/07 për Procedurat e Rekrutimit, si dhe Udhëzimin e ri Administrativ 2024/01 për Rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Me 27 Mars kemi shpalle konkurset publike për Kabinetin e Kryshefit: Këshilltarë të Kabinetit dhe Assistente në Kabinetin e KE. Konkurset si më lartë janë mbyllur me datë 08.04.2024 ndërsa për Kabinetin me 11.04.2024.

***__Zyra ligjore__***

Përveq punëve të zakonshme me të cilat përballet shërbimi, gjatë periudhes tremujore Janar-Mars 2024 është zhvilluar procedurë për lëndët e mëposhtme:

| Nr. | I paditur/debitor | Paditës/kreditor | Kontesti | Rrjedha |
|---|---|---|---|---|
| 1. | NPH "Iber Lepenc" | Hamit Osmani | Kompenzim dëmi | Seanca e dt.05.01.2024 , ku eshte caktuar nga Gjykata edhe eksperti i pavarur nga lemia e hidroteknikës per te hartuar ekspertizen. |
| 2. | Ismet Leci | NPH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Me dt.09.01.2024 eshte mbajtur seanca e rradhes , ne mungese te pales se paditur. Me dt.15.01.24 kemi pranuar plotesimin e ekspertizes gjeodezike dhe me dt.24.01.24 kemi dorezuar precizimin e padise konform ekspertizes gjeodezike.<br><br>Me dt 06.03.2024 eshte mbajtur seanca perfundimtare, presim Aktgjykimin nga Gjykatës e shkalles se pare. |
| 3. | Xhabir Leci | NPH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Seanca e dt.18.01.2024, pala e paditur nuk eshte paraqitur, por procedura do te vazhdohet me anë të shpalljeve në tabelën e Gjykates. Seanca e rradhes e mbajtur me dt.13.02.2024-ku dhe u caktua eksperti i pavarur nga lemia e gjeodezise. Me |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | date 20.03.2024 kemi dorzuar ne gjykate precizimin e padise konform ekspertizes gjeodezike. Seanca e shqyrtimit kryesor eshte mbajtur me dt.21.03.2024 , presim Aktgjykimin e Gjykatës se shkalles se pare. |
| 4. | Fatmir Brahimi dhe<br><br>Blerim brahimi | NPH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Seancat pergtitore te dt.19.01.2024 dhe dt.12.02.2024, ku i kemi dorëzuar Gjykatës - precizimin e padise dhe kërkesëpadisë konform ekspertizes gjeodezike. Seanca perfundimtare eshte mbajtur me dt.06.03.2024, presim Aktgjykimin nga Gjykata e shkalles se pare. |
| 5. | NPH "Iber Lepenc" | Mejdi Krasniqi | Komenzim dëmi | Me dt.03.01.2024 kemi pranuar Aktvendimin Cnr.500/21 te dt.19.12.2023 me te cilin aprovohet pjeserishte padia dhe kerkesepadia e paditësit - Z.Mejdi Krasniqit.<br><br>Me dt.15.01.2024 kemi derguar Gjykates shkresën me te cilën e kemi ushtruar mjetin juridik "Ankesë" kunder Akvendimit C.nr.500/21 te dt.19.12.2023.<br><br>Presim Akvendimin nga Gjykata e Apelit. Me dt.13.02.2024 kemi pranar Ankesën e pales paditëse kundër Aktgjykimit të shkalles së parë C.nr.500/21 i dt.19.12.2023 .<br><br>Me dt.15.02.2024 e kemi dërguar përgjigjien në Ankesë drejtuar Gjykatës së Apelit. |
| 1. | Shefqet Aliu dhe Sheremet Aliu | NH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Seanca e mbajtur me dt.01.02.2024. Me dt 06.02.2024 i kemi derguar gjykates parashtresë-plotësim padie ne kuptim subjektiv |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | lidhur me vendndodhjen e te paditurit te dyte. |
| 2. | NH "Iber Lepenc" | Emin Zejnullahu | Pengim posedimi i pronës | Me dt.05.02.2024-kemi pranuar padine dhe aktvendimin per pergjigjie ne padi.<br><br>Me dt.15.02.2024-i kemi dorzuar ne gjykate pergjigjien në padi. |
| 3. | NH "Iber Lepenc" | Berat Lushtaku | Kontest Vendimi-kthim ne vendin e punes | Seanca e pare pergaditore eshte mbajtur me dt.12.02.2024 , ku me aktvendim u caktua eksperti financiar per te hartuar ekspertizen financiare.Me dt 04.03.2024 kemi pranuar ekspertizen financiare nga eksperti gjyqesore. Me dtae 19.03.2024 permes parashtreses kemi kundershtuar eksperitzen financiare. Me dt 22.03.2024 eshte mbajtur seanca perfundimtare, presim Aktgjykimin nga Gjykata e shkalles se pare |
| 5. | NH "Iber Lepenc"<br><br>I paditur i tretë | Celic Zoran | Pengim posedimi | Seanca e caktuar per dt.12.02.2024 nuk eshte mbajtur pasi qe gjyqtari ka munguar ne seancë. |
| 7. | Ismet Mehmeti | NH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Seanca e rradhes e mbajtur me dt.20.02.2024. |
| 8. | NH "Iber Lepenc" | Imer Hajdar | Kompenzim dëmi | Seanca pergaditore e mbajtur me dt.20.02.2024. Seanca e rradhes e mbajtur me dt.18.03.2024 , ku gjykata caktoi ekspertët e pavarur nga lëmia e gjeodezise dhe hidroingjinierise per hartimin e ekspertizave dhe matjeve në terren. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9. | Ismajl Fazliu | NH ”Iber Lepenc” | Lirim prone | Seanca perfundimtare e mbajtur me dt.22.02.2024 ku edhe u lexuan provat , presim aktgjykimin nga Gjykata e shkalles se pare. |
| 10. | Agim Leci | NH ”Iber Lepenc” | Lirim prone | Seanca perfundimtare e mbajtur me dt.22.02.2024 ku edhe u lexuan provat , presim aktgjykimin nga Gjykata e shkalles se pare. |
| 11. | Ferki Leci | NH ”Iber Lepenc” | Lirim prone | Seanca perfundimtare e mbajtur me dt.23.02.2024 ku edhe u lexuan provat, presim aktgjykimin nga Gjykata e shkalles se pare. Me dt.04.03.2024 kemi pranuar Aktgjykimin C.nr.1685/13 te dt.23.02.2024 me te cilin aprovohet ne teresi si e bazuar padia e N.H.”Iber -Lepenc” ne favor te ndermarrjes, presim nese pala e paditur do te ushtroje mjetin juridik ”Ankesë” ne Gjykatën e Apelit ne te kunderten do te mirret klauzola e plotfuqishmerise. |
| 1. | NPH ”Iber Lepenc” | Avni Haliti | Kompenzim dëmi | Seanca e fillestare e mbajtur me dt.04.03.2024 , ku pala paditëse bëri precizimin e padise duke shtuar edhe dy pale tjera si të paditur, presim ftesen nga Gjykata per seancen e rradhes. |
| 5. | NPH ”Iber Lepenc” | Refiqe Govori | Vërtetim pronësie | Seanca e shqyrtimit kryesor eshte mbajtur me dt.13.03.2024. Me dt.18.03.2024 kemi dorezuar me shkrim edhe fjalen përfundimtare, presim Aktgjykimin e Gjykatës se shkalles se pare. |
| 6. | Ilmije Qoku | NPH ”Iber Lepenc” | Lirim prone | Seanca e dt.15.03.2024 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9. | Ahmet Seferi | NPH "Iber Lepenc" | Lirim prone | Seanca e rradhës e mbajtur me dt.22.03.2024, ku dhe u caktua nga Gjykata eksperti i pavarur nga lëmia e gjeodezisë , për të hartuar ekspertizën sipas matjeve dhe gjendjes në terren . |

***Zyra e Prokurimit***

Gjatë tremujorit të parë 2024 (TM1 2024), Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar këto aktivitete:

| # | Nr prok | Titulli | Data e inicimit | Procedura | Data e hapjes | Nënshkrimi i kontratës | Vlera e kontratës | Kompania fituese | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 044/23 | Mirëmbajtaja e ERP sistemit NAV dhe blerje e licencave shtesë | 04.12.2023 | E hapur | 29.12.2023 | 19.01.2024 | 24.756,40 | **ASSECO SEE** | |
| 2 | 045/23 | Rehabilitimi i nyjeve sanitare në Drejtori | 07.12.2023 | E hapur | 09.01.2024 | 05.02.2024 | 10.322,64 | **MEGRANT ING** | |
| 3 | 046/23 | Ndarja e dy zyreve ne objektin e Drejtorisë | 08.12.2023 | E hapur | 12.01.2024 | 02.02.2024 | 6.898,28 | **Grupi i OE "Eng Bau" SH.P.K. & "BTB icon" SH.P.K** | |
| 4 | 047/23 | Furnizim me sistem për | 12.12.2023 | E hapur | 15.01.2024 | 09.02.2024 | 14,834 | **KOSOVA INFORMATION** | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | hyrje – dalje dhe video vëzhgim | | | | | .00 € | **TECHNOLOGY SH.A** | |
| 5 | 048/23 | Furnizim me Firewall, Router dhe Switch | 14.12.2023 | E hapur | 17.01.2024 | 27.02.2024 | 38,429.83 € | **“CLASTER TECH” SH.P.K** | |
| 6 | 049/23 | Furnizim dhe montim të sistemit të IP kamerave ne objektet e NJP, SP dhe ON | 15.12.2023 | E hapur | 19.01.2024 | / | / | / | **Anuluar për shkak se asnjë ofertues nuk ka qenë i pranueshëm** |
| 7 | 050/23 | Furnizim me fazoneri - RITENDER | 19.12.2023 | E hapur | 22.01.2023 | / | / | / | **Anuluar për shkak se nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme.** |
| 8 | 051/23 | Sanimi dhe renovimi i Objekteve Ndarëse dhe Stacioneve Pompike | 26.12.2023 | E hapur | 24.01.2024 | / | / | / | **Anuluar për shkak të ofertave që kanë tejkaluar tej mase çmimin e paraparë** |
| 9 10 | 24-001 | Sanimi i Drenazhës në objektine zyres SCADA | 11.01.2024 | E hapur | 18.01.2024 | 28.02.2024 | 2,133,75 € | **MEGRANT ING** | |
| 11 | 24-002 | Furnizim me dy MFP Printer | 12.01.2024 | E hapur | 23.01.2024 | | | **"ILIR - .3KOSOVA " SH.P.K.,** | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Color A4 | | | | 04.03.2024 | 2,832.00 € | | |
| 12 | 24-003 | Studimi i Fizibilitetit për sistemin hidraulik në objekte ndarese, pultave komanduese dhe modernizimi për rritjen e eficiences ne stacione pompike - RITENDER | 15.02.2024 | E hapur | 15.03.2024 | 27.03.2024 | 14,960.00 € | **Instituti I Shkencës Dhe I Teknologjisë Insi SH.P.K.,** | |
| 13 | 24-04 | Furnizim me material higjienik | 16.02.2024 | E hapur | 27.02.2024 | 15.03.2024 | 3,761.70 € | **PM GROUP SH.P.K.,** | |
| 14 | 24-005 | Furnizim dhe vendosja e aktuatorëve në valvula ⌀ 600 në SP Bivolak - RITENDER | 21.02.2024 | E hapur | 14.03.2024 | 27.03.2024 | 39,990.20 € | **N.SH. BF ENERGY** | |
| 15 | 24-006 | Furnizim me flamuj të vegjël dhe flamuj të mëdhenjë në shtiza | 22.02.2024 | E hapur | 26.02.2024 | 28.02.2024 | 797.68 € | **Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.** | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 24-007 | Furnizim me fazoneri – RITENDER 1 | 23.02.2024 | E hapur | 20.03.2024 | / | / | / | **Anuluar sepse nuk ka pasur asnje ofertues te pranueshem** |
| 17 | 24-008 | Furnizim me uniforma dhe mjete mbrojtëse pune për vitin 2024 | 28.02.2024 | E hapur | 22.03.2024 | / | / | / | Në proces |
| 18 | 24_009 | Servisim i 3 automjeteve | 05.03.2024 | Kuotim i çmimit 1,990.00 € | 11.03.2024 | 21.03.2024 | 1,477.66 € | | **Anuluar pas vleresimit dhe Vendimeve, per shkak te gabimeve aritmetike ne cmim dhe duhet te ritenderohet** |
| 19 | 24_010 | Furnizim dhe pajisje me GPS GNSS dhe pjesët tjera përcjellëse | 06.03.2024 | E hapur 27,000.00 € | 27.03.2024 | 19.03.2024 | / | / | Pezulluar aktiviteti i prokurimit para hapjes sipas kërkesës për rishqyrtim dhe jemi ne pritje te pergjigjes se OSHP. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | 24_011 | Furnizim me material teknik për punëtori në mekanike në Shkabaj | 07.03.2024 | E hapur 14,000.00 € | 28.03.2024 | / | / | / | Në proces |
| 21 | 24–012 | Riparimi i Eskavatorit | 26.03.2024 | Vlere minimale 990.00 € | 27.03.2024 | 28.03.2024 | 990.00 € | **Gazmend Bojku B.I** | |
| 22 | 24_013 | Furnizim me pajisje higjienike | 27.03.2024 | Vlere minimale 800.00 € | 27.03.2024 | 29.03.2024 | 342.85 € | **PM GROUP SH.P.K.,** | Në proces |
| 23 | 24_014 | Riparimi i Kamionetes Renault Master | 28.03.2024 | Kuotim i çmimit 2,500.00 € | 05.04.2024 | | | | Në proces |

***<u>Departamenti Planifikim dhe Zhvillim</u>***

Të bashkangjitura gjeni aktivitete dhe veprimet punuese nga DPZH përgjatë muajve :Janar,Shkurt dhe Mars 2024.

Përgjat këtijë TM ka vazhduar aktiviteti punues nga muajit paraprak si dhe ka pasur zhvillime tjera të cilat janë në kompetencen e drejtorisë.

Në TM1,2024 janë realizuar këto aktivitete:

- " Mirëmbajtja e ERP sistemit NAV dhe blerje të licencave shtesë", me nr. Prokurimi IL-23-13561-2-2-1, nr.prot. 06-214 të datës 19.01.2024, për të cilën është përgatitur vendimi për caktimin e menaxherit dhe nënshkrimi i planit të menaxhimit.
- Për kontratën "Furnizimi dhe montimi i tabelave sinjalizuese përgjatë kanalit kryesor" është bërë azhurnimi i PMK, me datën 10.01.2024.
- Gjithashtu kemi pranuar disa raporte nga menaxheret e kontratave si në vijim:
- "Sigurimi shëndetësor për personelin e Ibër Lepenc-it", raporti I radhës me nr. 09-196, I datës 17.01.2024 nga menaxherja e kontratës Arijeta Ujkani-Qerimi.
- "Mirëmbajtja e ERP sistemit NAV dhe blerje të licencave shtesë", raporti me nr. 05-212, i datës 19.01.2024 nga menaxheri Behar Shaqiri.

- "Furnizim me material reprezentativ"- raporti me nr. 09-183, i datës 15.01.2024 nga menaxheri Galdim Buja.e evidencave të projekteve kapitale dhe paraqitja e tyre në tabela.

- Si dhe aktivitete tjera në kuadër të punëve në bashkëpunim me drejtoritë tjera dhe obligimeve te marrura nga KE.

- Për kontraten me titull "Sanimi i rrëshqitjes së dheut dhe kanalit kryesor Mihaliq-Besi në Babinmost" është bërë rishikimi i dokumenteve nga Komisioni actual dhe analizimi i punimeve paraprake ne lidhje me një pretendim te mos pageses se një facture per OE "DIJAMANTI"punë e mbetur nga komisjoni i kaluar dhe percjellë ne Financa.

- Është bërë Propozimin për zëvëndesimin e menaxherit të kontrates me titull "Sigurimi shëndetësor për përsonelin e Ibër-Lepencit" ku menaxherja Arjeta Ujkani Qerimi zëvëndesohet me menaxheren e re të kësaj kontrate Dorentina Thaqi.

- Mbajtja e evidencave të projekteve kapitale,percjellja e tyre .

Poashtu këtë muaj kemi pranuar nga departamenti i prokurimi disa kontrata me titull:

- "Ndarja e dy zyreve në objektin e Drejtorisë" me nr Prokurimi IL-23-13754-5-2-1 dhe nr. prot. 06-348; te dates 02.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- "Rehabilitimi i nyjeve sanitare në Drejtori" me nr Prokurimi IL-23-13705-5-2-11 dhe nr. prot. 02-353; te dates 05.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- "Sanimi i drenazhes në objektin e zyres SCADA" me nr Prokurimi IL-24-117-5-3-6 dhe nr. prot. 02-709; te dates 28.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- "Furnizim me sistem për hyrje-dalje dhe video vezhgim" me nr Prokurimi IL-23-13850-1-2-1 dhe nr. prot. 02-475; të dates 09.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- "Furnizim me Firewall, Router dhe Switch" me nr Prokurimi IL-23-13905-1-2-1 dhe nr. prot. 02-697; të dates 27.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- "Furnizimi me flamuj të vegjel dhe flamuj të mëdhenjë me shtiza" me nr Prokurimi IL-24-1380-1-4-7 dhe nr. prot. 02-708; të dates 28.02.2024 për të cilën është përgatitur vendimi për KE për caktimin e menaxherit dhe mbikqyrësit të drejtperdrejt te menaxherit dhe pergaditja edhe nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës.

- Gjithashtu kemi pranuar disa raporte nga menaxherët e kontratave si në vijim:

- "Sigurimi shëndetësor për personelin e Ibër Lepenc-it", raporti i radhës me nr. 08-365, i datës 05.02.2024 nga menaxherja e kontratës Arijeta Ujkani-Qerimi.

- "Servisimi i aparateve për mbrojten kunder zjarrit ", raporti përfundimtarë me nr. 05-621, i datës 21.02.2024 nga menaxheri i kontratës Kujtim Redenica

- "Furnizim me karrige pune ", raporti përfundimtarë me nr. 05-702, i datës 27.02.2024 nga menaxheri I kontratës Shqiprim Kodra

*Njësia zbatuese e projektit WSCP*

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

**Projekti me Bankën Botërore**

| | |
|---|---|
| **RAPORTI TREMUJOR (TM1_2024)** | |
| **Emri i Kontratës:** | **Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit - WSCP** |
| **Investitori** | **N.H. "Ibër Lepenc" sh.a Prishtinë** |
| **Nën-projektet** | **1.Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit**<br>**2.Konsulenca**<br>**3.SCADA** |
| | |
| | |
| **1. Emri i Projektit** | **Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit** |
| **Kontraktori** | **"Famis.CO and Kit AK Gradnje"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **24/05/2023** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **12,875,191.63 €** |
| | |
| **2. Emri i Projektit** | **Konsulenca – Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor** |
| **Kontraktori** | **"IPE Proing sh.p.k"** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **08/06/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **270,700.00 €** |
| | |

| | |
|---|---|
| 3. **Emri i Projektit** | **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA** |
| **Kontraktori:** | **JV Interadira & OSKAR-EL** |
| **Data e firmosjes së kontratës** | **21/05/2019** |
| **Çmimi i Kontratës:** | **1,072,044.24 €** |
| **Vlera e punimeve të kryera:** | **899,923.20 €** |

**Periudha Raportuese: 01.10.2023 - 31.12.2023**

**Aktivitetet e punës dhe raportimi i tyre**

**Punimet e rehabilitimit dhe riparimit përfshijnë si më poshtë:**

1. Rindërtimi i pjesëve të hapura të të kanalit trapezoid dhe drejtkëndësh me Beton (gjatësia totale përafërsisht 9,194.70 m në gjithsej 55 seksione, në komunat: Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, dhe Obiliq), duke ruajtur rrjedhën e panderprerë të Ujit.

2. Zëvendësimi i kanalit të hapur pranë fshatit Zubin Potok me elemente nga betoni dhe mbulesë të kanalit (gjatësia përafërsisht 400 m).

3. Ndërtimi i sektorit të dytë 2 të Rezervuarit Bufer me gjatësi 800 m dhe gjerësi 8m'.

4. Riparimi i Akuadukteve me gjatësi 24600.23m2, riparimi Ii sipërfaqes së brendshme të akuadukteve duke riparuar vrimat dhe aplikimin e materialit hidroizolues si shtresë e sipërme duke përfshirë trajtimin e fugave sipas Specifikimit Teknik dhe kërkesave të furnizuesit.

Numri i akuadukteve është 17 copë me gjatësi totale përafërsisht. 1,989,264.01m në komunat Zubin Potok 7, Mitrovicë 2 dhe Vushtrri 8.

5. Punime të tjera

Ndërtimi i murit mbrojtës 318 m'

Pastrimi dhe rivendosja e 41 lëshesave ekzistuese dhe ndërtimi i 10 kanaleve të reja

Ndërtimi i 21 kutive të shpërndarjes së ujit (dhoma betoni nëntokësore direkt në buzë të kanalit me marrjen e ujit nga kanali)

Instalimi i 13 rrjetave metalike në kalimine kanalit nga seksionet e kanalit të hapur në atë nëntokësor.

Punimi i gropave septike (pellgje betoni nëntokësor, 4 x 8,000L), për lidhje me shtëpitë afër kanalit.

6. Çështjet mjedisore

Ekzekutimi i punimeve të riparimit dhe rehabilitimit duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIAF), Kornizën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMF), Kornizën e Politikave të Zhvendosjes (KPZH), politikat dhe procedurat e Bankës Botërore, si dhe legjislacioni.

- Kontraktori "JV Famis Co dhe Kit AK Gradnje"
  Vazhdimi i punimeve në kanalin kryesor

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 24.05.2023, kontraktori "Famis Co dhe Kit AK Gradnje" kanë paraqitur Planin Dinamik të mobilizimit në teren dhe kanë filluar punët sipas kushteve të kontratës FIDIC, ku bazohet projekti "Rehabilitimi i kanalit kryesor të Ibër Lepencit".

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kontraktori ka punuar me disa pozicione të punimeve:

**Buffer Rezervar**

Në datën 19 korrik 2023, Kontraktori ka filluar me aktivitete në Rezervuarin Bufer me demolimin dhe gërmimin e dheut. Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, kontraktori ka përfunduar pothuajse të gjithë gjatësinë e punimeve të betonimit dhe armimit, duke mbetur vetëm seksioni për kyçje në kanalin ekzistues, si dhe punimet për drenazhimin rreth mureve të betonit

Në datën 24 korrik 2023, Kontraktori ka filluar me aktivitetet në murin mbajtës, në Km 28+862 deri në Km 29+182, me gjatësi 320m'. Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka përfunduar të gjitha punimet në lidhje me murin mbrojtës.

Gjithashtu, më 26 korrik 2023, kontraktori ka filluar pastrimin e kanaleve ekzistuese. Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka përfunduar 7 nga 41 kanale ekzistuese,

Gjatë kësaj periudhe të raportimit Kontraktori ka filluar punimet për ekzekutimin e kutive të Shpërndarjes së Ujit dhe nga 21 të parapara në projekt ka përfunduar 10

Deri në këtë periudhë raportuese i gjithë progresi është afërsisht 40 %

**Rehabilitimi i Akuadukteve**

Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e të gjithë segmentit PAK2.1, PAK2.2, PAK2.3, PAK2.4, PAK2.6 dhe PAK3.5 të, duke arritur në afërsisht 50% të progresit për Rehabilitimin e Akuaduktit, ose duke përfunduar 1063.52m' nga 2129.89m'.

**Punët e Betonit**

Gjithashtu, më 26 korrik 2023, kontraktori ka filluar pastrimin e kanaleve ekzistuese. Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka përfunduar 7 nga 41 kanale ekzistuese.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit Kontraktori ka filluar punimet civile për ekzekutimin e kutive të Shpërndarjes së Ujit dhe nga 21 të parapara në projekt ka përfunduar 10 copë.

**Kanalet drejtkëndëshe**

Sektori i kanalit të hapur drejtkëndëshe L = 1,753.39 m' ka filluar më 18 shkurt 2024, kontraktori ka nisur bypass-in, buzë kanalit anësor, tek Segmenti A15 në Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47, dhe në segmentin A16 Km 47+551.50 deri në Km 47+620.0.

Gjatë muajit mars, kontraktori ka përfunduar rreth 70% të segmentit A16 Km 47+551.50 dhe në Km 47+620.0, ose rreth 48m' nga 68.50

Përveç anashkalimeve në segmentet A15 dhe A16, Kontraktori ka filluar ekzekutimin e bypass-i të tretë nga kanali anësor, në segmentin A17 me gjatësi 130.51 m'

Me këtë lloj anashkalimi janë paraparë të kryhen në së paku L=1,032.30m nga L=1,753.39m'.

**Më poshtë janë paraqitur disa foto të punimeve në teren:**



















- *__Konsulenca – IPE Proing__*

*__Mbikqyrja e punimeve gjatë realizimit të punimeve në kanalin kryesor__*

Pas nënshkrimit të kontratës me datën 08.06.2022, kompania mbikqyrëse IPE Proing, ka filluar me zbatimin e kontratës, duke angazhaur stafin në teren pasi që kontraktori ka filluar punimet dhe bashkarisht kemi filluar me takimet e rregullta javore, si dhe procedurat tjera të parapara me kontratë.

**Ndërlidhja në terren**

Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur vizita të shpeshta në teren, vizita këto që janë bërë me qëllim të përcjelljës së punimeve në kanal.

1. **Furnizimi dhe montimi i sistemit SCADA**

**Përshkrimi i Përgjithshëm i punëve të përfunduara nga sistemi SCADA**

- **Studimet e Dizajnit dhe Ekzekutimit**
- **Furnizimet**
- **Rinovimi i Portave**
- **Prodimi I kabinetit elektrik SCADA**
- **Instrumentalizimi**
- **Qendra Globale e Kontrollit**
- **Përfundimi dhe Dorëzimi Formal (në ILC) i Sistemit SCADA si e integruar tërësisht**
- **Dokumente/vizatime të ndërtuara (siç kërkohet për Sistemin e pranuar përfundimisht SCADA)**

Për projektin e SCADA-s, deri më tani është bërë instalimi i kabineteve, censorë dhe pajisjet e tjera, lidhja e sinjaleve dhe me serverin SCADA ka përfunduar, në të gjitha pikat e mëposhtme:

- DO1 – Verbnice, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO2 – Mihaliq, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO3 – Hamidi, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik.

- DO4 – Drenicë, duke përfshirë instalimin e kabinetit të ri elektrik dhe lyerjen e portave si pjesë e punimet e rinovimit.

- MSHP Besi, duke përfshirë ndërtimin e pusetave të reja (pasi puseta ekzistuese nuk i përshtatej

kërkesat për instalimin e matësit të rrjedhës) dhe instalimin e matësit të rrjedhës.

- MSHP Bivolak, duke përfshirë ndërtimin e pusetave të reja dhe instalimin e matësit.

- PSI 1 – Cagllavice, duke përfshirë instalimin e matësit të rrjedhës në pusetën ekzistuese.

- PSI 2 – Samadrexhë,

- PSI 4 - Pantine,

- PSI 7 – Fushtice,

- PSI 8 – Gjurashin,

- PSI 9 – Korroticë,

- PSI 10 – Krashtice,

- TC "Kosova A", duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës dhe kabineti SCADA i jashtëm me mbrojtje rrethojash.

- Ferronikel, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës.

- KRU Mitrovica, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit dhe valvulës dhe kabineti SCADA i jashtëm me mbrojtje rrethojash.

- KRU Mitrovicë-Vushtrri, duke përfshirë ndërtimin e pusetave dhe instalimin e matësit të rrjedhës dhe valvule dhe kabinet SCADA te jashtem me mbrojtje rrethoje.

- KRU Prishtina, duke përfshirë instalimin e matësit të rrjedhës, kabinetin SCADA dhe kyçjen në

matësit e rrjedhës.

- TC "Kosova B", në këtë lokacion është paraparë të vendoset matësi i rrjedhës dhe valvula në tubacionet në pusetat e sapondërtuara por gjendja ekzistuese në këtë lokacion është se është kanal i hapur, ne - TC "Kosova B", në këtë lokacion është paraparë të vendoset fluorometri dhe valvula në gypa në pusetat e sapo ndertuara por situata ekzistuese ne ketë kantier është se është kanal i hapur.

Punimet programuese të konfigurimit të RTU dhe ngarkimi i grafikëve në HMI kanë përfunduar në të gjitha faqet e implementuara, për faqet e mbetura imitimet e serverit SCADA dhe grafika HMI janë gati dhe zbatohet dhe do të lidhet sapo të instalohen pajisjet në këto vende.

Cilësia dhe mbulimi i rrjetit të operatorëve celularë, ndërkohë që Ibër Lepenci ka zgjidhur problemin me rrjetin e shpërndarjës të internetit me fibra optik për instalimin në të gjitha lokacionet siç është parashikuar.

Aktivizimi i internetit përmes furnizimit të internetit me fiber optik pritet të bëhet shumë shpejtë dhe më pas sistemi SCADA do të funksionoi sipas projektit dhe nevojave të Ibër Lepencit.

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE **"IBËR - LEPENC"** SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE **"IBËR - LEPENC"** J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE **"IBËR - LEPENC"** D.D.

# Raporti tre mujor, Janar-Mars 2024 TM1

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e katër (4) të rregullt të mbajtur me datë 30.04.2024 pas shqyrtimit të Raportit TM1-2024 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i BD: |
| Nënshkrimi | **Faruk MUJKA** | **Bajram MUSTAFA** |
| Data: 30.04.2024 | | |